

*Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, zhvilluar me procedurën e gjyqimit të shkurtuar, administroi provat dhe i vlerësoi ato në tërësi, në raport me parashikimet e ligjit procedural dhe material penal, bazuar në nenet 112, 152, 190, 261, 274, 275, 375, 379, 380, 387, 388, 389, 403, 405, 406 të Kodit të Procedurës Penale, nenet 25, 35, 36, 40, 45, 47-57, 55, 59, 60, 248, 260, 287, 259, 186, 164/b, 244, 245, 164/a, 143, 144/a të Kodit Penal, dhe ligjin nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”,*

#### VENDOSI:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Lefter Koka**, për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (*fakti penal lidhur me procedurën e shpronësimit*) dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij **me 3 (tre) vite burgim**.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Lefter Koka**, për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë*”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij **me 6 (gjashtë) vite burgim**.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Lefter Koka**, për kryerjen e veprës penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 pg 2, i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij **me 8 (tetë) vite burgim**.
4. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Lefter Koka** dënohet me një dënim të vetëm prej **10 (dhjetë) vite burgim**.
5. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Lefter Koka** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **6 (gjashtë) vite e 8 (tetë) muaj burgim**.
6. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Lefter Koka** do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
7. Në zbatim të nenit 35 pg 1 të Kodit Penal, të pandehurit **Lefter Koka** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.
8. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Alqi Billako**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, në referim te nenit 388, pika 1 të K.Pr.Penale.
9. Në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal, deklarimin fajtor të të pandehurit **Alqi Billako**, për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **4 (katër) vite burgim**.
10. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Alqi Billako** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite e 8**

*(tetë)muaj burgim.*

11. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Alqi Bllako** do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
12. Në zbatim të nenit 35 pg 1 të Kodit Penal, të pandehurit **Alqi Bllako** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.
13. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Pëllumb Abeshi**, për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **3 (tre) vite e 6 (gjashtë) muaj burgim**.
14. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Pëllumb Abeshi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite e 4 (katër) muaj burgim**.
15. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit **Pëllumb Abeshi** për një periudhë kohe prej **4 (katër) vjetësh**, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij, **duke filluar afati i provës nga e nesërmja e shpalljes së vendimit**.
16. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, caktuar ndaj të pandehurit **Pëllumb Abeshi** me vendimin nr.22, datë 26.03.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
17. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit **Pëllumb Abeshi** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.
18. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Pëllumb Abeshi** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.
19. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Florjan Muçaj**, për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **3 (tre) vite burgim**.
20. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Florjan Muçaj** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite burgim**.
21. Bazuar në nenin 261 , pika 1, shkronja c) të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “*Arrest në burg*” , caktuar ndaj të pandehurit **Florjan Muçaj** me vendimin nr.22, datë 26.03.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak se kohëzgjatja e paraburgimit është më e madhe se masa e dënimit të dhënë.
22. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit **Florjan Muçaj** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.
23. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Florjan Muçaj** i hiqet e drejta për të

ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.

24. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Azem Shatëri**, për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimit e tij me **3 (tre) vite burgim**.
25. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Azem Shatëri** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite burgim**.
26. Bazuar në nenin 261, pika 1, shkronja c) të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, caktuar ndaj të pandehurit **Azem Shatëri** me vendimin nr.22, datë 26.03.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak se kohëzgjatja e paraburgimit është më e madhe se masa e dënimit të dhënë.
27. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit **Azem Shatëri** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.
28. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Azem Shatëri** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.
29. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Erjon Murataj**, për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimit e tij me **3 (tre) vite burgim**.
30. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Erjon Murataj** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite burgim**.
31. Llogaritja e dënimit fillon nga data e ekzekutimit të vendimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Erjon Murataj** do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
32. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Erjon Murataj** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.
33. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Sabina Cenameri**, për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimit e saj me **3 (tre) vite burgim**.
34. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës **Sabina Cenameri** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite burgim**.
35. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurës **Sabina Cenameri** për një periudhë kohe prej **4 (katër) vjetësh**, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj, **duke filluar afati i provës nga e nesërmja e shpalljes së vendimit**.
36. Bazuar në nenin 261 dhe 389 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “*Arrest në shtëpi*”, caktuar ndaj të pandehurës **Sabina Cenameri** me vendimin nr.22, datë 26.03.2022 të Gjykatës së

Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

37. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurës **Sabina Cenameri** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.
38. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Arben Dervishaj**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, nga personi që ka për detyrë të lëshohjë dokumentin, parashikuar nga neni 186, pg 3 i Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1 të K.Pr.Penale.
39. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Arben Dervishaj**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv në sektorin privat*”, parashikuar nga neni 164/b i Kodit Penal, në referim te nenit 388, pika 1 të K.Pr.Penale.
40. Bazuar në nenin 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, caktuar ndaj të pandehurit **Arben Dervishaj** me vendimin nr.82, datë 11.11.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
41. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit **Arben Dervishaj** nga paraburgimi nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.
42. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Klodian Zoto**, për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **2 (dy) vite burgim**.
43. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Klodian Zoto**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal (para ndryshimeve me ligjin nr.43/2021), në referim te nenit 388, pika 1 të K.Pr.Penale.
44. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Klodian Zoto**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244 (para ndryshimeve me ligjin nr.43/2021), në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, në referim te nenit 388, pika 1 të K.Pr.Penale.
45. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Klodian Zoto**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv në sektorin privat*”, parashikuar nga neni 164/a i Kodit Penal, në referim te nenit 388, pika 1, shkronja d) të K.Pr.Penale.
46. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Klodian Zoto**, për kryerjen e veprës penale “*Mashtrimi*”, me pasoja të rënda, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 143, pg 3 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **7 (shtatë) vite burgim**.
47. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Klodian Zoto**, për kryerjen e veprës penale “*Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 144/a në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **6 (gjashtë) vite burgim**.
48. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Klodian Zoto**, për kryerjen e veprës penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 pg 2, i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **8**

*(tetë) vite burgim.*

49. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Klodian Zoto** dënohet me një dënim të vetëm prej **12 (dymbëdhjetë) vite burgim.**
50. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Klodian Zoto** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **8 (tetë) vite burgim.**
51. Llogaritja e dënimit fillon nga data e ekzekutimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Klodian Zoto** do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
52. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Loran Dusha**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, të K.Pr.Penale.
53. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Loran Dusha**, për kryerjen e veprës penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 pg 2, i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij **me 7(shtatë) vite burgim.**
54. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Loran Dusha** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **4 (katër) vite e 8 (tetë) muaj burgim.**
55. Llogaritja e dënimit fillon nga data e ekzekutimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Loran Dusha** do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
56. Në zbatim të nenit 40 të Kodit Penal, të pandehurit **Loran Dusha** i hiqet e drejta për ushtrimin e detyrave drejtuese pranë personave juridikë, për një kohë prej **5 (pesw) vitesh.**
57. Deklarimin e pafajshme të të pandehurës **Arjola Kodra**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244 (para ndryshimeve me ligjin nr.43/2021), në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1 të K.Pr.Penale.
58. Bazuar në nenin 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “*Arrest në shtëpi*”, caktuar ndaj të pandehurës **Arjola Kodra** me vendimin nr.82, datë 11.11.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
59. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arbër Denizi**, për kryerjen e veprës penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 pg 2, i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij **me 7 (shtatë) vite burgim.**
60. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Arbër Denizi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **4 (katër) vite e 8 (tetë) muaj**

*burgim.*

61. Llogaritja e dënimit fillon nga data e ekzekutimit dhe dënimi me burgim nga i pandehuri **Arbër Denizi** do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme, në referim të parashikimeve të nenit 18, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
62. Në zbatim të nenit 40 të Kodit Penal, të pandehurit **Arbër Denizi** i hiqet e drejta për ushtrimin e detyrave drejtuese pranë personave juridikë, për një kohë prej **5 (pesw) vitesh**.
63. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Juri Ymeraj**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 pg 2, i Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1 të K.Pr.Penale.
64. Bazuar në nenin 389 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, caktuar ndaj të pandehurit **Juri Ymeraj** me vendimin nr.82, datë 11.11.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
65. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Regan Merdani**, për kryerjen e veprës penale “*Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 144/a në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **3 (tre) vite burgim**.
66. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Regan Merdani** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite burgim**.
67. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Regan Merdani** për një periudhë kohe prej **4 (katër) vjetësh**, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij, **duke filluar afati i provës nga e nesërmja e shpalljes së vendimit**.
68. Bazuar në nenin 389 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, caktuar ndaj të pandehurit **Regan Merdani** me vendimin nr.82, datë 11.11.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
69. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Regan Merdani** nga paraburgimi, nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.
70. Në zbatim të nenit 40 të Kodit Penal, të pandehurit **Regan Merdani** i hiqet e drejta për ushtrimin e detyrave drejtuese pranë personave juridikë, për një kohë prej **5 (pesw) vitesh**.
71. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Gentian Zifla**, për kryerjen e veprës penale “*Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 144/a në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me **3 (tre) vite burgim**.
72. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Gentian Zifla** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vite burgim**.

73. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit **Gentian Zifla** për një periudhë kohe prej **4 (katër) vjetësh**, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij, *duke filluar afati i provës nga e nesërmja e shpalljes së vendimit*.
74. Bazuar në nenin 389 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se dënimi me burgim u pezullua me kusht, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, caktuar ndaj të pandehurit **Gentian Zifla** me vendimin nr.82, datë 11.11.2022të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
75. Urdhërohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit **Gentian Zifla** nga paraburgimi, nëse nuk mbahet për shkak të një vendimi tjetër.
76. Në zbatim të nenit 40 të Kodit Penal, të pandehurit **Gentian Zifla** i hiqet e drejta për ushtrimin e detyrave drejtuese pranë personave juridikë, për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.
77. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, **shoqëria tregtare “Integrated Technology Services” sh.p.k**, me NUIS L02302032C me seli qendrore në Tiranë, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, në referim te nenit 388, pika 1, të K.Pr.Penale dhe ligjit nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.
78. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, **shoqëria tregtare “Integrated Technology Services” sh.p.k**, me NUIS L02302032C me seli qendrore në Tiranë, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 pg 2, i Kodit Penal, në referim te nenit 388, pika 1, të K.Pr.Penale dhe ligjit nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.
79. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, **shoqëria tregtare “Integrated Technology Services” sh.p.k**, me NUIS L02302032C me seli qendrore në Tiranë, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Mashtrimi*”, me pasoja të rënda, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 143 pg 3 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, në referim të nenit 388, pika 1, të K.Pr.Penale dhe ligjit nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.
80. Bazuar në nenet 389 dhe 275 të Kodit të Procedurës Penale, heqjen e masës së sigurimit pasuror “*Sekuestro preventive*”, vendosur ndaj personit juridik, shoqërisë tregtare “*Integrated Technology Services*” sh.p.k, me NUIS L02302032C, me seli qendrore në Tiranë, caktuar me vendimin nr. 134, datë 28.03.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
81. Deklarimin fajtor të të pandehurit, **shoqëria tregtare “ITNEG” sh.p.k**, me NUIS L713230370, me seli qendrore në Tiranë, (me adresë rruga “*Dervish Luzha*”, nr. 27, Njesia Bashkiake nr. 8), akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar*”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar

nga neni 144/a dhe 25 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni, në lidhje me nenin 45 të Kodit Penal dhe ligjin nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, neni 9, pika 1, shkronja b) dhe neni 12, caktimin ndaj tij të dënimit **“mbarimi i personit juridik”**.

- 82.** Deklarimin fajtor të të pandehurit, **shoqëria tregtare “Froggy” sh.p.k**, me NUIS L57108231A, me seli qendrore në Vlorë, (me adrese: Kote, Drashovice, Rruga Nacionale Vlore-Drashovice km 11, Lagjja Kallafet, ndërtesë private, kati i parë, nr. pasurie 5/1”), akuzuar për kryerjen e veprës penale *“Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar”*, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 144/a dhe 25 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni, në lidhje me nenin 45 të Kodit Penal dhe ligjin nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, neni 9, pika 1, shkronja b) dhe neni 12, caktimin ndaj tij të dënimit **“mbarimi i personit juridik”**.
- 83.** Deklarimin fajtor të të pandehurit, **shoqëria tregtare “Pupa Services” sh.p.k**, me NUIS L62409501B, me seli qendrore në Durrës, (me adrese: Spitallë, km 1, godinë 1 katëshe, nr.12/2), akuzuar për kryerjen e veprës penale *“Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar”*, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 144/a dhe 25 i Kodit Penal, dhe në bazë të këtij neni, në lidhje me nenin 45 të Kodit Penal dhe ligjin nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, neni 9, pika 1, shkronja b) dhe neni 12, caktimin ndaj tij të dënimit **“mbarimi i personit juridik”**.
- 84.** Në bazë të nenit 274 dhe 190 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal, **konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit**, të pasurisë së paluajtshme me **nr.26/212/ND-N-4**, vol 49, faqe 58, Zona Kadastrale 8512, lloji i pasurisë “njësi”, me sipërfaqe 789 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Durrës, në pronësi të shtetasit Lefter Koka, sekuestruar nëpërmjet vendimit për caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” me nr. 134, datë 28.03.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, *deri në vlerën që i korrespondon asaj të produktit të veprës penale, sipas pjesës arsyetuese të vendimit*.
- 85.** Bazuar në nenet 389, 190 dhe 275 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 36 të Kodit Penal, heqjen e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive”, caktuar me vendimin nr. 134, datë 28.03.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe kthimin e sendeve/pasurive që janë lënë në ruajtje pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara Tiranë, personave që iu përkasin, për pasuritë/sendet e sekuestruara, si vijon: **(i)** pasuria e paluajtshme nr. 26/212/ND-34, vol 51, faqe 179, ZK 8512, e llojit “njësi”, me sipërfaqe 1140 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Durrës, në pronësi të shtetasit Lefter Koka; **(ii)** pasuria e paluajtshme nr. 26/212/ND-N-2, vol 49, faqe 56, ZK 8512, e llojit “njësi”, me sipërfaqe 789 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Durrës, në pronësi të shtetasit Lefter Koka; **(iii)** pasuria e paluajtshme nr. 26/212/ND-N-35, vol 51, faqe 180, ZK 8512, lloji i pasurisë “njësi”, me sipërfaqe 626.8 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Durrës, në pronësi të shtetasit Lefter Koka; **(iv)** pasuria e paluajtshme me nr. 2/373+1-77, vol 4, faqe 84, ZK 8280, lloji i pasurisë “apartament”, me sipërfaqe 99.48 m<sup>2</sup>, me adresë “Rruga



e Elbasanit”, shk.1, k.11, ap.77, në pronësi të shtetasit Edmond Bllako.

86. Në bazë të nenit 190, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, sendet e sekuestruara prova materiale, që i janë bashkuar fashikullit të dërguar për gjykim, të qëndrojnë të sekuestruara për shkak të çështjes penale të ndarë.
87. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për ekzekutimin e vendimit.
88. Shpenzimet procedurale të bëra gjatë hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurve të deklaruar fajtorë, në mënyrë solidare.
89. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

*U shpall në Tiranë sot më datë 25.09.2023*